- Menaxhere e kontratës "Mirëmbajtja teknike e objekteve Komunale"
- Menaxhere e kontratës "LOT-1-Ndërtimi i Cerdhës në Roganë-Kamenicë"
- Menaxhere e kontratës "LOT-1-Ndërtimi i Cerdhës në Roganë-Kamenicë"
- Menaxhere e kontratës "Ndërtimi i tezgave per tregje mobile"

Leotrim Spahiu: menaxhon-imbikëqyrë këto projekte:

- Menaxher i kontratës “Ndërtimi i kanalizimit fokal në Kamenicë dhe fshatra Shipashnicë, Karagevë, Busavatë, Kopërmicë, Koretin dhe Topanicë-Ritenderim 2 KM653-23-7865-5-2-1/C465
- Menaxher i kontratës “Asfaltimi i Rrugëve Komunale LOT 2”
- Menaxher i kontratës “Ndërtimi i parkut në qendër e vjetër të qytetit Kamenicë”
-

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë:

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë funksionon në kuadër të Komunës së Kamenicës

Aktualisht ka një përbërje prej:

- Qendra Komunale e Biznesit
- Qendra për Zhvillim Ekonomik
- Sektori për Turizëm

Bazuar në objektivat e parapara, DZHEH-ja, duke vepruar drejt realizimit të tyre, gjatë periudhës Janar - Qershor 2025, ka mundur të realizimin e disa aktiviteteve dhe nën aktiviteteve të parapara në kuadër të objektivave:

1. Marrëveshja me Agjencionin e punësimit të Rep.së Kosovës

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë ka filluar përgaditjet për organizimin e trajnimeve për të gjitha gratë në Komunën e Kamenicës dhe këto trajnime do të mbahen në fushën e kontabilitetit, dizajnit grafik dhe në bashkëpunimin me Qendrën për Aftësim Profesional në Gjilan ku komuna ka marrë përsipër mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit.

Gjate këtij viti (2025) ne fushën e kontabilitetit janë certifikuar 4 persona, tashme ne kemi shpallur thirrjen publike per aftësim profesional ne fushën e dizajnit grafik, kontabilitetit dhe administrim biznesi.

2. Marrëveshja me Agjencionin e punësimit të Rep.së Kosovës

Kemi finalizuar marrëveshjen e re me APRK-në, ku jemi ne proces te shpalljes se thirrjes publike per angazhimin e praktikanteve brenda sektorëve te komunës e cila pune praktike do te kompenzohet 170.euro.

3. Mbështetja e bizneseve start up dhe biznese egzistuese përmes granteve me vlerë 132,000.00 euro

Veprimtaria	Nr. Përfutuesve	Gjinia		LOT	
		F	M	LOT 1	LOT 2
Prodhuese	12	6	6	6	6
Përpunuese	3	1	2	1	2
Shërbuese	47	9	38	26	21
Ndërtimore	12	0	12	7	5
Tregtare	0	0	0	0	0
	74	16	58	40	34

4. Sesion informues në Kamenicë dhe Roganë për Thirrjen për grante per bizneset e vogla dhe start up

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë ka mbajtur një sesion informues për skemen e granteve në Kamenicë, në sallën e Kuvendit Komunal dhe në fshatin Roganë.

Në këto takime, u prezantua udhëzuesi për aplikimin në skemen e granteve, i cili synon mbështetje për zhvillimin e bizneseve dhe përmirësimin e mundësive ekonomike.

Në sesionet informuese morën pjesë qytetarë, pronarë të bizneseve dhe përfaqësues të ndryshëm të komunitetit, të cilët patën mundësinë të informohen dhe të shprehin interesin e tyre për aplikim.

Komuna e Kamenicës vazhdon të mbështesë iniciativat që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e qytetarëve.

5. Identifikimi i shtigjeve te reja për ecje

Është bërë identifikimi i disa shtigjeve për ecje jemi, kemi filluar me shenjëzimin e 3 shtigjeve, shtegu Astrit Dehari ka përfunduar, pas përfundimit të shenjëzimit të 3 shtigjeve do të fillojmë edhe me digitalizimin e këtyre shtigjeve.

Shtegu "Astrit Dehari", shtegu "Nuh Berisha", shtegu i "Kranidellit"

6. Shqyrtimi i kërkesave për dhënie në shfrytëzim të pronave publike

7. Diskutim publik për projektin: 'Ndërtimi i objekteve të pashfrytëzuara komunale dhe adaptimi i tyre në bujtina malore në zonat rurale të Kamenicës: Ferigevë, Kranidell, Desivojë'

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka mbajtur takimin publik për projektin: 'Ndërtimi i objekteve të pashfrytëzuara komunale dhe adaptimi i tyre në bujtina malore në zonat rurale të Kamenicës: Ferigevë, Kranidell, Desivojë'.

Të pranishëm në këtë konsultim ishin Drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik, Burbuqe Leka, zyrtarë nga kjo drejtori, zyrtarë komunal, arkitekti Ernal Canaj, qytetarë, OJQ dhe të tjerë.

Lokacionet janë Ferigevë, Kranidell dhe Desivojë që së pari të jenë pjesë e këtij pilot projekti dhe arsyeja pse këto lokacione është për shkak të infrastrukturës dhe se banorët që kanë shprehur interesim. Ndërsa pas adaptimit të tyre mendojmë t'i lidhim me sektorin privat. Poashtu përveç që t'i lidhim me sektorin privat këto bujtina kemi opsion edhe për thirrje publike si dhe me ndërmarrjen publike Dardana

Objekti i parë është shkolla në Ferigevë me sipërfaqe 115 metra katror, ku mendojmë ta kthejmë në bujtinë dhe mund të sistemohen deri në 19 persona. Vlera investive është diku 90 deri në 110 mijë Euro. Objekti i dytë është shkolla në Kranidell me sipërfaqe 265 metra katror, ku mendojmë ta kthejmë në bujtinë dhe mund të sistemohen deri në 34 persona. Vlera investive është diku 100 deri në 130 mijë Euro. Objekti i tretë është shkolla në Desivojë me sipërfaqe 480 metra katror, ku ende nuk i kemi dhënë një kahje por mund të sistemohen deri në 48 persona. Vlera investive është diku 180 deri në 210 mijë Euro.

Për këtë projekt është aplikuar në MZHR për realizimin e tij.

8. Prezantime të projekteve për Ministrinë e ndryshme si dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare. Takime dhe trajnime të ndryshme për realizimin e projekteve të ndryshme

9. Marreveshje bashkepunimi me organizaten Renesanca

U nënshkrua marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën "Renesansa"

Kjo marrëveshje është nënshkruar në prag të shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Kancerit- 4 Shkurtit

Me këtë marrëveshje, Komuna e Kamencës do të mbulojë anëtarësimin e grave të prekura nga kanceri, duke u ofruar mundësi për shërbime të ndryshme si:

- ◆ Proteza
- ◆ Brusa
- ◆ Mbështetje psikologjike
- ◆ Fizioterapi

Ky është një hap konkret drejt ndihmës dhe mbështetjes për ato që kanë nevojë më shumë

10. Faza e fundit e aplikimit ne Programin BFC SEE (Business Friendly Certificate)

Komuna ka përmbyshur thuajse të gjitha kriteret eliminuese dhe deri tani ka ngarkuar mbi 255 dokumente në sistemin e vlerësimit të ofruar nga ekspertët e projektit.

Ky certifikim do të sjellë përfundim të jashtëzakonshme për komunën tonë, duke përfshirë:

Përmirësimin e klimës për investime dhe biznes – do të rrisë besimin e investitorëve dhe do të tërheqë më shumë investime, si të huaja ashtu edhe të brendshme.

Rritje të mundësive për zhvillim ekonomik – duke krijuar mundësi për bizneset ekzistuese dhe të reja.

Mbështetje për ndërmarrjet dhe inovacionin – do të krijojë kushte më të mira për zhvillimin e bizneseve të reja dhe nxitjen e sipërmarrësisë.

Përmirësimi i shërbimeve dhe procedurave administrative – do të lehtësohen proceset për të siguruar leje, licenca dhe shërbime të tjera të nevojshme për zhvillimin e biznesit.

Pesëmatrje më e lehtë në fondet e BE-së dhe fondet ndërkombëtare – certifikimi do të sigurojë që komuna jonë të mos skenohet negativisht gjatë aplikimeve për financime dhe mundësira të tjera mbështetëse nga fondet ndërkombëtare.

11. Takim me organizaten Séisscontact për mundësi të vazhdimit të projekteve

Ne kete takim eshte diskutuar për zhvillimin e një produkti të ri turistik, që do të kontribuonte në rritjen e turizmit dhe promovimin e destinacioneve tona.

U bisedua për ecurinë e projektit aktual – Zip Line si dhe për një hap të ri përpara: zhvillimin e një produkti të ri turistik, që do të kontribuonte në rritjen e turizmit dhe promovimin e destinacioneve tona. Kjo mundësi e re do të krijojë mundësi për rritje, zhvillim dhe angazhim të akterëve të fjerë në industrinë e turizmit.

12. Projektet te cilat jane inicuar ne prokurim publik

- Parku i avanturave ne vlere prej 300,000.00 euro
- Vieë point ne vlere prej 30,000.00 euro
- Tezgat per tregje mobile ne vlere prej 20,000.00 euro
- Stendat per panair ne vlere prej 16,000.00 euro
- Hartat turistike ne vlere prej 3,000.00 euro
- Baby box ne vlere prej 103,000.00 euro
- Bujtinat malore ne vlere prej 400,000.00 euro

QENDRA KOMUNALE E BIZNESVE

Në Qendrën Komunale te Bizneseve për periudhën Janar - Qershor 2025 janë pranuar 186 kërkesa ku të gjitha janë shqyrtuar brenda afatit të caktuar.

Tabela 1. Numri i kërkesave të pranuar - QKRB

Kërkesa	Regjistrim	Ndryshime +Informata	Shuarje	Duplikat	Certifikata të reja RKS	Vërtetime
Numri	48	20+94	4	7	13	0

STRUKTURAE BIZNESEVE TË REGJISTRUARA

Tabela 2. Struktura e bizneseve të regjistruara

Emërtimet	Janar - Qershor 2025				Gjithsej
	Prodhuese	Tregtare	Shërbyese	Ndërtimore	
Biznese të regjistruara	14	4	22	8	48
Biznese Individuale					33
Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar					15
Tjera	0	00	00	00	0
Struktura Gjimore	Femra		Meshkuj		
	10		38		48

STRUKTURAE BIZNESEVE TË ÇREGJISTRUARA

Tabela 3. Struktura e bizneseve të çregjistruara

Emërtimet	Janar - Qershor 2025				Gjithsej
	Prodhuese	Tregtare	Shërbyese	Ndërtimore	
Biznese e çregjistruara	0	2	2	0	4
Biznese Individuale					3
Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar					1
	Femra		Meshkuj		

Struktura	1	3	4
Gjinore			

KRAHASIMI NË MES TË BIZNESEVE TË REGJISTRUARA DHE TË ÇREGJISTRUARA PËR MUAJT JANAR-QERSHOR 2025

Tabela 4. Krahasimi i bizneseve të regjistruara dhe të çregjistruara

Emërtimet	Janar-Qershor 2025				
	Te regjistruara			Të çregjistruara	
Prodhuese		14		0	
Tregtare		4		2	
Shërbyese		22		2	
Ndërtimore		8		0	
Gjithsej		48		4	
	Janar-Qershor 2025				
Emërtimet	Prodhuese	Tregtare	Shërbyese	Ndërtimore	Gjithsej
Ndryshime te bizneseve	6	4	8	2	20
Biznese Individuale					12
SH.P.K.					7
Të tjera					1
Struktura	Femra		Meshkuj		
Gjinore	5		15		20

KËRKESAT PËR NDRYSHIME TË BIZNESEVE

Tabela 5. Kërkesat për ndryshim të bizneseve

- Kjo qendër ka përpiluar raporte mujore financiare dhe të punës për Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe atë:
- raporte tremujore
 - gjashtëmujore

- nëntëmuore dhe
- njëvjeçare

Përveç kësaj, OKB ka ofruar ndihmë, informata dhe këshilla rreth aplikimit për regjistrim të biznesit.

Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencia:

Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektoratit dhe Emergjencia, ka kryer obligimet dhe detyrat e veta konform Ligjeve dhe Akteve tjera nënligjore, Rregulloret Komunaie dhe Vendimit për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Drejtorive të Administratës Komunaie. Kjo drejtori në kuadër të saj i ka 4 (katër) sektorë.

- Sektori i SHP (Shërbime Publike);
- Sektori për MMA (Menaxhimin e Mbeturave dhe Ambientit);
- Sektori i Inspektoratit dhe
- Sektori për Emergjencia.

1. SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE (SHP) DHE SEKTORI PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE, DHE AMBIENTIT (MMA)

❖ Staff

- Udhëheqës i Sektorit të SHP, 1
- Udhëheqës i Sektorit për MMA, 1
- Zyrtar i ambientit, 1
- Zyrtar për KEK dhe PTK, 1
- Zyrtar administrativ, 1
- Mirëmbajtës të ambientit, 2

Duke pasur para sysh Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencia sipas kompetencave dhe përgjegjësi që ka, ka një përgjegjësi të theksuar në kryejen e detyrave të ndryshme në infrastrukturën rrugore, mirëmbajtjen e rrugëve, sinjalizimin e rrugëve, mirëmbajtjen e ambientit, hapësirat publike, gjithashtu është përgjegjëse për të bashkëpunuar në fushën e mbeturinave, dhe ujësjellësit me kompanitë përgjegjëse, atëherë mundë të konstatojmë se kjo drejtori punon me një numër jo të mjaftueshëm të staft.

❖ **Mirëmbajtja e pargëve, shesheve dhe hapësirave të gjelbra publike**

Për mirëmbajtjen e hapësirave publike, është e kontraktuar NPL “Dardana” Sh.a. e cila kujdeset dhe mirëmban hapësirat publike në qytetin e Kamenicës, varrezat dhe lapidarët e dëshmorëve. Komuna ka nënshkruar një kontratë me NPL “Dardana” Sh.A. e cila ka marrë për sipër mirëmbajtjen e të gjitha hapësirave publike si dhe menaxhimin e Zip-line. Hapësirat publike të cilat përfshihen në kontratë fillojnë nga Berivojca, rruga “Adem Jashari” në dy anët e rrugës ku përfshihet edhe mirëmbajtja e trotuareve dhe pastrimi i rrugës, mirëmbajtja e drunjtëve dekorativ duke vazhduar në rrugën “Skënderbeu” ku përfshihen të gjitha hapësirat publike në dy anët e rrugës, bulevardi i qytetit, trotuarët dhe hapësirat tjera deri te ura që kalon në lagjen “Malësia”. Po ashtu përfshihet edhe përroi i Rubocit që vazhdohet me mirëmbajtje deri ish stacioni i autobusëve. Këto hapësira që i cekëm më lartë mirëmbahen në mënyrë intensive në baza ditore, por mirëmbajtja bëhet edhe në rrugët tjera në qytet si: në rrugën “Sylë Zarbina”, Rrugën “Tahir Sinani, dhe rrugë tjera sipas nevojës. Përveç këtyre bëhet edhe mirëmbajtja lapidareve dhe varrezave të dëshmorëve, mirëmbajtja e shtrait të lumit etj. Gjithashtu sipas kërkesave të këshillave lokale bëhet edhe pastrimi i varrezave në qytet dhe lokalitete tjera, varësisht nga gjendja e tyre. Edhe punëtorët e mirëmbajtjes nga drejtoria jonë janë gjithmonë në terren dhe ndihmojnë pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave tjera publike të pa përfshira në kontratë, e që vlerësohet se ka nevojë të pastrohen. Në tabelën e më poshtme do t'i paraqesim sipërfaqen e hapësirave publike, gjelbëruese që mirëmbahet rregullisht në mënyrë intensive sipas kontratës.

Tabela Nr. 1: Sipërfaqet e Hapësirave të gjelbra publike

Nr.	Emërtimi	Sipërfaqja (m ²)
1	Mirëmbajtja intensive e hapësirave gjelbëruese	92,994.00
2	Pastrimi i lumit të qytetit	59,500.00
3	Varrezat e dëshmorëve dhe lapidarët	31,886.00
Sipërfaqja e përgjithshme (m²)		184,380.00 m²

❖ Aksionet dhe fushatat e pastrimit të ambientit

Në këtë periudhë kemi planifikuar, dhe realizuar disa aksione për pastrimin e ambientit, edhe atë:

• **Me 21 Mars është organizuar një aksion për mbjelljen e drunjtëve dekorativ, me rastin Ditës Ndërkombëtare të Pyjeve**

Për nder të Ditës Ndërkombëtare të Pyjeve, është bërë mbjellja e disa drunjtëve dekorativ në parkun e qytetit dhe lagjen Iliria, ku kemi pasur dëmtim të drunjtëve dekorativ, dhe të njëjtit janë zëvendësuar me drunj të rinj. Gjithashtu është bërë edhe pastrimi i disa rrugëve në qytet ku kanë marrë pjesë punëtorët e NPL “Dardana”, si dhe punëtorët e mirëmbajtjes nga drejtoria e jonë.

• **Me 22 Prill, për nder të Ditës së Tokës** është zhvilluar aksioni për pastrimin e Ambientit, ku janë pastruar disa depони ilegale, në rrugën për ballë parkut të qytetit, rruga “Tahir Sinani” në Kamenicë, në rrugën afër urës kryesore në Berivojcë, te pishat në Kamenicë si dhe në lagjen e spitalit ku janë të vendosur kontejnerët e mbeturinave. Në këtë aksion kemi pasur edhe përkrahjen e KL, dhe vullnetarëve të tjerë, qytetarëve që na u kanë bashkuar. Më vonë është vazhduar edhe me pastrimin e shtrait të lumit “Krive Reka nga punëtorët e NPL, dhe të drejtorisë tonë. Gjithashtu edhe në të gjitha shkollat e Komunës janë organizuar aksione ku është bërë pastrimi oborrave të shkollave dhe i hapësirave për rreth. Thasët me mbeturina janë marrë nga kompania Ecohigjiena e cila bën edhe menaxhimin e mbeturinave komunale.

- **Më 26 Maj, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Biodiversitetit**, është mbajtur aksioni “**Për një Kamenicë të pastër**”, pasi data 24 ishte ditë vikendi, ku është bërë pastrimin i disa deponive ilegale në qytet dhe lokalitete tjera si Bërviojë, Katushnicë, në rrugën e Tugjeçit.

Realizimi i projekteve

- ❖ **Furnizimi me lodra për fëmij**, projekti e ka vlerën 80,000.00 €.
Projekti është financuar nga Komuna.

- ❖ **Ndërtimi i kanalizimit fokal në Kamenicë dhe fshatra**, vlera e këtij projekti është 40,000.00 €. Projekti është vazhdim i vitit paraprak.

- ❖ **Mirëmbajtja e kanalizimit dhe Infrastruktura komunale**, projekti e vlerën 150,000.00 €. Është në procedurat e prokurimit. Projekti është i financuar nga Komuna.

- ❖ **Pastrimi i lumenjve**, Vlera e projektit është 150,000.00 €, është në procedurat e prokurimit, i financuar nga Komuna.

- ❖ **Furnizimi me material për tregullimin e Ujëseve në qytet**, vlera e projektit është 6,000.00 €, i financuar nga Komuna. Është në procedurat e prokurimit.

- ❖ **Mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve lokale**

Për vitin 2025 në kontratën për mirëmbajtjen e rrugëve lokale janë të planifikuara 250,000.00€ ku tani ve janë duke u trajtuar kërkesat e qytetarëve për shtuarjen e rrugëve në zhavorr. Vlen të ceket se ka një numër të madh të kërkesave të qytetarëve.

- ❖ **Sinjalizimi Vertikal dhe Horizontal**

Punët për vendosjen e sinjalizimit Vertikal dhe Horizontal janë duke u realizuar sipas planifikimit ku tani jemi në përfundim të fazës së parë. Për vitin 2025 janë të planifikuara 45,000.00 €.

- ❖ **Zgjerimi i rrjetit të Ndriçimit Publik**

Në projektin për zgjerimin e ndriçimit publik për vitin 2025 janë të ndara 23,982.00 €, ku rrjeti është zgjeruar edhe me 94 trupa ndriçues apo 3640 m gjatësi, në 7 lokalitete të komunës. Në tabelën e më poshtme do të paraqesim lokalitetet ku kemi zgjerim të Ndrëçimit publik në vitin 2025:

Tabela nr.2 Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik sipas lokaliteteve.

Zgjerimi i rrjetit të Ndrëçimit publik sipas lokaliteteve në vitin 2025			
Nr.	Lokalitetet	Trupa ndriques në (copë)	Gjatësia e rrjetit në (m)
1	Berivojë	6	240
2	Busavatë	23	920
3	Kamenicë	31	1240
4	Kopernicë	4	160
5	Petroc	2	80
6	Rogaçicë	17	680
7	Shipashnicë e Poshtme	9	320
TOTALI		94 trupa	3,640.00 m

❖ **Mirëmbajtja e Ndrëçimit publik,** vlera e projektit është 35,000.00€, është nënshkruar kontrata me OE përzgjedhës, është funksionalizuar rrjeti në përgjithësi në tërë territorin e komunës dhe tani janë duke u zhvilluar punët në terren për përmirësimin dhe ndërtimin e poqëve të djegur, si dhe evitimin e problemeve tjera. Momentalisht rrjeti i Ndrëçimit publik është funksional në tërë territorin e komunës së Kamenicës.

Në komunën e Kamenicës aktualisht kemi rreth **144.95 km** gjatësi të rrjetit me ndriçim publik, apo **3462 trupa ndriçues, në të gjitha lokalitetet e komunës tonë, si në tabelën në vijim.**

Tabela Nr. 3. Ndrëçimi publik në Komunën e Kamenicës (shtrirja sipas Lokaliteteve)

Nr.	Shtrirja e rrjetit të Ndrëçimit publik sipas lokaliteteve		
	Lokalitetet	Trupa ndriçues në (copë)	Gjatësia e rrjetit në (m)
1	Berivojë	126	5040
2	Bosçë	35	1400
3	Busavatë	89	3545

4	Dajkoc	44	1760
5	Hajnoc	42	1680
6	Hodonoc	227	9080
7	Hogosit	157	6280
8	Kamenicë	898	35960
9	Karagëvë e Epërme	130	5200
10	Karagëvë e Poshtme	182	7280
11	Kollolëq	21	840
12	Kopernicë	110	4400
13	Koretin	284	11360
14	Krilevë	34	1360
15	Moçar	19	760
16	Muçivërc	221	8840
17	Novosellë	25	1000
18	Petroc	91	3640
19	Rogaçicë	304	12160
20	Ruboc	82	3280
21	Strezoc	67	2680
21	Shipashnicë e Epërme	99	3960
22	Shipashnicë e Poshtme	70	2800
23	Topanicë	266	10640
TOTALI		3462 trupa	144 945 m

❖ **Transporti lokal, linjat urbane dhe urbane-periferike, dhënia e lejeve për Taxi**

Më datë 16 Maj, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencia, kemi publikuar shpalljen publike për dhënie e vijave të pa mbuluar në komunën e Kamenicës, ku shpallja do të jetë e hapur një muaj për aplikimin e operatorëve transportues. Pas përfundimit të afatit për aplikim do të merren të gjitha kërkesat dhe do të trajtohen sipas vendeve përkatëse të aplikimit.

Dhënia e lejeve për ushtrimin e veprimtarisë së Taxive është duke shkuar normalisht ku vërehet një numër më i madhe i aplikimeve pas aprovimit të rregullores komunale, ku Taxit lirohen nga pagesa për marrjen e lejes përkatëse.

❖ **Të hyrat nga regjistrimi i automjeteve**

Të hyrat nga regjistrimi i automjeteve për periudhën Janar - Maj 2025, do ti paragesim në tabelën në vijim.

Tabela Nr. 4. Të hyrat nga regjistrimi i automjeteve (Janar-Maj/ 2025)

Nr	Muaji	Të hyrat nga regjistrimi i automjeteve (EUR)	
		Nr. i aplikimeve	Shuma e mjeteve në €
1	Janar	530	5335 €
2	Shkurt	483	5000 €
3	Mars	526	5435 €
4	Prill	618	6278 €
5	Maj	605	6060 €
TOTALI		2 762	28 108 €

❖ **Dhënia e lejeve për shfrytëzimin e hapësirave publike për periudhën më pak se 1 vit**

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambientit dhe Inspektoratit duke u bazuar në kompetencat e veta që ka, menaxhon me hapësirat publike duke dhënë pronën publike në shfrytëzim të përkohshëm më pak se një vit sipas të dhënave të paraqitur në tabelën e më poshtme.

Tabela Nr. 5. Lejet për shfrytëzim të hapësirave publike (Janar – Maj/ 2025)

Nr.	Muaji	2025	
		Nr. i Aplikacioneve	Të hyra në €
1	Janar	2	695.29
2	Shkurt	3	/
3	Mars	2	1,336.80

4	Prill	3	/
5	Maj	1	36.45
TOTALI		11	2,032.54 €

Si që po duket gjatë kësaj periudhe i kemi pasur 11 kërkesa, të cilat janë trajtuar nga komisioni përkatës, prej tyre 5 kërkesa kanë marrë përgjigje pozitive, ndërsa 6 kërkesa nuk i kanë plotësuar kriteret dhe janë refuzuar.

❖ **Të hyrat nga kiosqet dhe garazhet**

Në këtë periudhën Janar – Maj/2025, nga të hyra për kioska nuk janë realizuar, ndërsa për garazhe janë inkasuar 50.00€. Duhet cekur se ngarkesa për faturimin e kioskave dhe garazheve nuk ka mundur të bëhet nga viti 2016 pasi duhet zhvilluar disa procedura për lidhjen e kontratave me pronarët e tyre, por kjo nuk mundë të bëhet pa përfunduar hartimi i Hartave Zonale.

❖ **Të hyrat nga Lejet Mjedisore komunale (LMK)**

Në këtë periudhë vetëm në muajin Janar kemi pasur vetëm një kërkesë për LMK, dhe e njëjta është pozitive, vlera e pagesës është 1575.60€ .

❖ **Të hyrat nga Harmonizimi i vijave**

Te harmonizimi i vijave shpallja publike për aplikim është bërë më 16 Maj, dhe e njëjta është e hapur deri më 16 Qershor, andaj akoma nuk është llogaritur.

❖ **Të hyrat e tjera për grupimin e tokës urbane dhe jo urbane, si dhe lejet tjera për mbvilljen e rrugëve.**

Në tabelën e më poshtme do të paraqesim të hyrat, për periudhën Janar-Maj 2025.

Tab.nr.6 Të hyrat nga ndërhyrja në infrastrukturë dhe dhënia e lejeve për hyrje në rrugë.

Nr.	Muaji	Ndërhyrje në infrastrukturë		Leje për hyrje në rrugë	
		Nr. i kërkesave	Vlera në €	Nr. i kërkesave	Vlera në €
1	Janar	/	/	/	/
2	Shkurt	/	/	/	/
3	Mars	1	180.50	2	40
4	Prill	/	/	1	20
5	Maj	2	181.80	1	15
Totali		3	362.30€	4	75.00€

❖ **Të hyrat e përgjithshme**

Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencia për periudhën Janar – Maj/ 2025, ka arritur të inkasoj të hyrat nga shërbimet e ndryshme, si në tabelën e mëposhtme:

Tabela Nr. 7. Të hyrat e përgjithshme për periudhën Janar – Maj /2025

Nr.	Pagesat sipas kategorisë	2025
1	Taksat për regjistrimin e automjeteve	28,108.00 €
2	Shfrytëzimi i hapësirave publike më pak se një vit	2,032.54 €
3	Shfrytëzimi i HP, gropimi i tokës urbane dhe jo urbane, si lejet tjera për mbylljen e rrugëve.	437.30 €

4	Të hyrat nga kiosqet dhe garazhet	50.00 €
5	Leje mjedisore komunale	1,575.60 €
Totali		32,203.44 €

❖ **Menaxhimi i shpenzimeve komunale: energjisë elektrike, ndriçimi publik, ujësjellës, mbeturina dhe telefoni fikse**
Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambientit dhe Inspektorait ka menaxhuar harxhimet e shërbimeve komunale, të cilat për periudhën raportuese Janar – Maj/2024, do ti paragesim në tabelën në vijim.

Tabela Nr. 8. Shpenzimet komunale (Janar-Maj/ 2025)

Nr.	Muaji	Administrata	Ndriçimi Publik	Uji	Tel. fikse	Mbeturinat
1	Janar	6,885.00	10,012.00	271.00	130.60	192.00
2	Shkurt	6,883.00	10,219.00	251.30	138.41	192.00
3	Mars	5,279.00	9,282.00	303.61	90.00	240.20
4	Prill	3,959.00	8,814.00	319.72	98.70	240.20
5	Maj	2,333.00	8,818.00	309.36	89.50	240.20
Totali		25,339.00	47,145.00	1,454.99	547.21	1,104.60

❖ **Menaxhimi i mbeturinave**

Menaxhimi i mbeturinave bëhet nga Ndërmarrja “Ecohigjiena”. Në kuadër të realizimit të Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave kemi vazhduar zgjerimin e rrjetit duke i furnizuar qytetarët me kontejner 120 L, ku secili qytetar pas pranimit të kontejnerit ka nënshkruar kontratë me kompaninë Ecohigjiena, e cila e bën grumbullimin e mbeturinave.

Sa i përket zgjerimit të rrjetit të mbeturinave, në këtë periudhë janë regjistruar edhe 70 klient të rinj, prej të cilëve 65 janë ekonomi familjare dhe 5 biznese.

❖ Menaxhimi i Ujësllësit dhe ujërave të zeza

Menaxhimi i ujësllësit bëhet nga KRU “Hidromorava”, njësia në Kamenicë.

Në tabelat e më poshtme do të paraqesim të dhënat për secilin ujësllës dhe lokalitet.

Ujësllësi në Qytetin e Kamenicës

Muaji	Prodhi mi (m ³)	Faturimi (m ³)	Faturimi (€)	Inkasimi (€)	Humbjet e Ujit në (%)	Inkasimi në %	Evitimi i rriedhje ve/defek tet tjera
JANAR	50393	23443	16525.1	16433.5	53.48	99.45	12
SHKURT	43465	243667	17206.3	15378	-460.61	89.37	21
MARS	39387	24369	17078.2	14128.1	38.13	82.73	15
PRILL	45150	25204.5	18078.2	14155	44.18	78.30	20
MAJ	44219	22629.5	16410.2	15141.5	48.82	92.27	33
QERSHOR							
Totali:	222614	339313	85298.1	75236.2			101

Ujësjetësi në Topaninë

Muaji	Prodhi mi (m³)	Faturimi (m³)	Faturimi (€)	Inkasimi (€)	Humbjet e Ujit në (%)	Inkasimi në %	Evitimi i rjedhje ve/defek tet tjera
JANAR	3750	3223	1908.07	1660	14.05	87.00	4
SHKURT	3120	2897	1772.69	1663.89	7.15	93.86	0
MARS	3610	3186	1898.53	1635.04	11.75	86.12	1
PRILL	5500	4437	2424.74	1758.32	19.33	72.52	3
MAJ	5270	4104	2302.42	1928.95	22.13	83.78	2
QERSHOR							
Totali:	21250	17847	10306.5	8646.2			10

Ujësjetësi në Karagavë e Poshitme

Muaji	Prodhi mi (m³)	Faturimi (m³)	Faturimi (€)	Inkasimi (€)	Humbjet e Ujit në (%)	Inkasimi në %	Evitimi i rjedhje ve/defek tet tjera
JANAR	3555	870	595.33	809.2	75.53	135.92	1
SHKURT	2979	908	613.19	561.84	69.52	91.63	1
MARS	2684	902	750.44	919.63	66.39	122.55	3
PRILL	3043	1213	812.86	835.03	60.14	102.73	4
MAJ	3370	1224	748.41	494.66	63.68	66.09	11
QERSHOR							
Totali:	15631	5117	3520.23	3620.36			20

Ujësjetësi në Kopernicë dhe Kolloleg

Muaji	Prodhi mi (m³)	Faturimi (m³)	Faturimi (€)	Inkasimi (€)	Humbjet e Ujit në (%)	Inkasimi në %	Evitimi i rriedhje ve/defek tet tjera
JANAR	1160	1674	1067.04	672.4	-44.31	63.02	0
SHKURT	810	1056	816.47	793.38	-30.37	97.17	1
MARS	690	1496	1064.23	442.62	-116.81	41.59	3
PRILL	990	2658	1515.55	889.42	-168.48	58.69	3
MAJ	1920	1847	1133.26	615.48	3.80	54.31	0
QERSHOR							
Totali:	5570	8731	5596.55	3413.3			7

Ujësjetësi në Koretin

Muaji	Prodhi mi (m³)	Faturimi (m³)	Faturimi (€)	Inkasimi (€)	Humbjet e Ujit në (%)	Inkasimi në %	Evitimi i rriedhje ve/defek tet tjera
JANAR	6180	2708	1598.06	2013.42	56.18	125.99	4
SHKURT	4670	2975	1740.57	1180.73	36.30	67.84	0
MARS	5170	2533	1532.15	1139.05	51.01	74.34	0
PRILL	7160	3769	2205.97	1780.54	47.36	80.71	5
MAJ	6380	3152	1815.96	1482.29	50.60	81.63	5
QERSHOR							
Totali:	29560	15137	8892.71	7596.03			14

Ujësjetlësi në Shipashnicë e Epërme

Muaji	Prodhi mi (m³)	Faturimi (m³)	Faturimi (€)	Inkasimi (€)	Humbyet e Ujit në (%)	Inkasimi në %	Eyitimi i trjedhje ve/defek tet tjera
JANAR	7020	2746	1462.63	1128.35	60.88	77.15	1
SHKURT	5420	2580	1391.34	1086.37	52.40	78.08	1
MARS	6040	2319	1282.24	635.84	61.61	49.59	0
PRILL	8290	2610	1483.48	1139.65	68.52	76.82	1
MAJ	8660	1938	1127.43	814.14	77.62	72.21	1
QERSHOR							
Totali:	35430	12193	6747.12	4804.35			4

❖ Kërkesat e qytetarëve përmes Qendrës së shërbimit të qytetarëve

Në tabelën e më poshtme do të paraqesim të dhënat lidhur me kërkesat e qytetarëve për periudhën Janar – Maj/2025

Tabela nr. 9. Pranimi dhe trajtimi i kërkesave të qytetarëve.

Nr.	Aktiviteti	2025
1	Kërkesa të pranuar	173
2	Kërkesa me përgjigje pozitive	96
3	Kërkesa me përgjigje negative	31
4	Kërkesa të bartura në drejtori dhe në sektor tjerë	11
5	Kërkesa në procedurë	35

Përveç kërkesave të pranuar për qendës për shërbim me qytetar kemi pasur edhe kërkesa tjera përmes emailit dhe kërkesa tjera përmes rrjeteve sociale, gojore dhe të drejtpërdrejta, të cilat janë trajtuar nga stafi i drejtorisë ku qytetarët kanë marrë përgjigjet e tyre.

2. SEKTORI I INSPEKTORIATIT

Staffi i sektorit të Inspektoratit:

- Udhëheqës i Sektorit të Inspektoratit, 1
- Inspektor i tregut, 2
- Inspektor i mbrojtjes së mjedisit, 1
- Inspektor i Komunikacionit, 1
- Zyrtar juridik, 1

Që nga muaji prill pozita e Inspektorit të ndërtimit është e zbrazët pasi i njëjti ka kaluar në një pozitë tjetër jashtë komunës, andaj nga data 21 Maj 2025 detyrat e inspektorit të ndërtimit është autorizuar ti kryej z.Enver Ismajli, inspektor i Tregut, deri në pranimin e një inspektori të ri, Gjithashtu edhe një inspektor i tregut nga muaji gusht shkon në pension dhe mbetet vetëm një inspektor i tregut.

Në vijim do ti paraqesim të dhënat për inspektimet e të gjitha fushave, për punët e kryera.

➤ Inspektime në fushën e Inspektorit të Tregut

Nr.	Aktiviteti, punët e kryera për muajin Janar-2025 Qershor- 2025	Aplikimet për Pëlqime-Vendim			Pëlqime të lëshuara		Vlera totale (€)	Personi përgjegjës
		Nr. aplikimeve	Të refuzuara	Nr. i Pëlqimeve, Vendimeve të lëshuara	Vlera në €			
1	Kerkesat e OE për Pëlqim-Vendim	8		8	160.00€	160.00€	Enver Ismajli	
2	Urdhëres për regjistrim të subjektit afarist.						Enver Ismajli	

	Ndalim i përkohshëm i veprimtarisë.	3	3			
3	Ankesa per mbrojtje te Konsumatoreve					Enver Ismajli
4	1. Gjoha mandatorë me Vendim. 2. Kallzim penal. 3. Përmbaruesi Privat	14=6600.00€ 3. Kallzime Penal Prokurori	14	6600€	3600.00€	1.Enver Ismajli
5	Vendimet e Ndërtimit	6	6			Enver Ismajli
	Totali		31	6760.00€	3760.00€	

- Mbyllja e dy lokaleve në Kamenicë me datë:20.03.2025 duke filluar nga ora 21:00h nga Inspektorati me shenja zyrtare “NDALOHET PËRKOHSHISHT VEPRIMTARIA”, njëri lokal është pajisur me Certifikat të Regjistrimit ka bërë kërkesë dhe ia kemi larguar shenjë zyrtare dhe është paisur me Pëlqim për ushtrimin e veprimtarisë, ndërsa lokali tjetër ka mbetur i mbyllur me shenjë zyrtare.

- Me datë; 21.05.2025 jam caktuar në kryerjen e punëve dhe detyrave inspektor i ndërtimit, për kundrazhi që jam caktuar në këtë detyrë përkohësisht nga ana profesionale nuk jam as i përafërt për kryerjen e punëve dhe detyrave të inspektorit të ndërtimit. Mbesë me shpresë të vendoset një inspektor i ndërtimit sa ma shpejt.

- Nga kërkesa e Operatorve Ekonomik janë inkasuar gjithësejt 160.00€ të cilat janë paisur me Vendim-Pëlqim për ushtrimin e veprimtarisë.

- Gjohat janë shqiptuar në kuadër të parregullsiive të Operatorve Ekonomik dhe Ndërtimeve pa leje ndërtimore, ku janë realizuar të hyra 3600.00€ dhe kam bërë tri(3) kallëzime penale në Prokurorin Themelore në Gjiian.

- Njoftim: Gjoha prej 900.00€, investitori ka paguar 900.00€, ndërsa vendimin e gjobës e ka pas me pague me 50% zbritje që i bie pagesa 450.00€.

Gjoha prej 200.00€, punëkryesi ka paguar 200.00€, ndërsa vendimin e gjobës e ka pas me pague me 50% zbritje që i bie pagesa 100.00€.

Gjoha prej 1000.00€, investitori nuk e ka paguar 1000.00€, ndërsa vendimin e gjobës e ka pas me pague me 50% zbritje që i bie pagesa 500.00€.

➤ **Inspektime në fushën e mjedisit**

Ky raport përmban të dhëna në lidhje me inspektimet në fushën e Inspektorit të Mjedisit, si dhe inspektimet tjera grupore për Gjashtë mujorin e Parë - 03.01-2025 - 12.06.2025

Lloji i veprimtarisë	Periodha kohore Janar- Qershor-2025	Shuma në € te paguara
Inspektime ne fushën e mjedisit	42	
Inspektime grupore me Inspektorët Komunal – Ndërtimit, Tregut , Komunikacionit etj.	36	
Procesverbale	17	
Vendime-Aktvendime	04	
Gjoha mandatorë dhe administrative	04	
Vlera e mjeteve nga këto gjoha	850euro	
Pletëparaqitje te përmbaruesi privat	00	
Kërkesa të shqyrtuara	11	
Urdhëresa për pajisje me Leje për shfrytëzimin e Hapësirës Publike.	6	

Presa më e madhe e inspektimeve kanë të bëjnë me zbatimin e masave ne baze te Rregulloreve Komunale ne bashkëpunim me inspektorin e Ndërtimit, Tregut, Komunikacionit etj.

➤ **Inspektimet në fushën e komunikacionit**

Ky raport përmban të dhëna në lidhje me inspektimet në fushën e Inspektorit e Komunikacionit, si dhe inspektimet tjera grupore për Gjashtë mujorin e Parë - 03.01-2025 - 19.06.2025

Lloji i veprimtarisë	Periodha kohore Janar- Qershor-2025	Shuma në € te paguara
Inspektime ne fushën e Komunikacionit	38	
Inspektime grupore me Inspektorët Komunal – Nderimit, Tregut , Mjedisit etj.	47	
Procesverbale	03	
Vendime-Aktivendime	02	
Gjoha mandatore dhe administrative	02	
Vlera e mjeteve nga këto gjoha	300 euro	
Fletëparaqitje te përmbartësi privat	00	
Kërkesa të shqyrtuara	09	
Procesverbale mbi Pranimin Teknik të Automjeteve për pajisje me Leje për Veprimtarinë Taxi të Udhëtarëve	22	

Pjesa më e madhe e inspektimeve kanë të bëjnë me zbatimin e masave në bazë të Rregulloreve Komunale në bashkëpunim me inspektorin e Nderimit, Tregut, Mjedisit etj.

Gjatë kësaj periudhe kohore Janar-Qershor 2025 së bashku me menaxherin e projektit z.Hysen Jerliu jam angazhuar në identifikimin e problemeve në sinjalizimin Horizontal dhe Vertikal në tërë territorin e Komunës së Kamenicës.

Si dhe gjatë kësaj periudhe kohore vazhdimisht kam asistuar në teren operatorin Ekonomik gjatë vendosjes së sinjalizimit Horizontal dhe Vertikal, ku janë vendosur,

Vendkalime të këmbësorëve, vija gjatësore të plota dhe të ndërprera, vendosja e shenjave Vertikale, kufizime të shpejtësisë, emërime të vendbanimeve, si dhe sinjalizimin e shtigjeve për ecje, etj.

Gjatë kësaj periudhe kohore Janar-Qershor 2025 së bashku me z.Ibrahim Kastrioti si dhe z.Sani Morina komisioni i emëruar për verifikimin e panove dhe reklamave në hapësira publike,

me datë 11.02.2025 ka filluar punën me verifikimin e reklamave në hapësira publike.

Me datën 18.02.2025, 19.02.2025 dhe 20.02.2025 kemi marrë aksion për largimin e panove dhe reklamave në hapësira publike në tërë territorin e qytetit të Kamenicës në bashkëpunim me NPL "DARADANA" dhe janë larguar gjithsejtë 35 reklama dhe pano të cilat ishin të vendosura pa lejen përkatëse nga organet komunale.

➤ **Bashkëpunimi i Drejtorisë për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencia me Institucione tjera**

Bashkëpunimi me institucione tjera Qendrore dhe Lokale gjithashtu ka një rëndësi të veçantë për DSHPALE, pasi kjo ndikon në përmirësimin e jetës së qytetarit dhe po ashtu e bën më të lehtë funksionimin dhe zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet tjera, mundë ti cekim bashkëpunimet si në vijim:

- Takime me Nivelin qendror, Ministri të linjës së Republikës së Kosovës;
- Takime të rregullta me AKK;
- Takime të rregullta me KRU "Hidromorava",
- Takime me ndërmarrjen "Ecoligjiena", ku kemi kërkuar edhe shtrirjen e ri jetës së grumbullimit të mbeturinave edhe nëpër lokalitete tjera, si dhe çështje tjera me interes të qytetarëve të Komunës së Kamenicës;
- Takime me Policinë e Kosovës, stacioni në Kamenicë, ku kemi kërkuar përkrahje në problemet eventuale që na paraqiten, dhe kemi marrë përkrahjen nga ta;
- Disa takime me përfaqësuesit e KEDS,
- Takime me GIZ, në lidhje me bashkëpunimin në fushën e mbeturinave, hartimin e PINKMM, etj.

➤ **Sfidat dhe problemet rreth organizimit të punëve**

Duke vlerësuar se Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencia brenda kompetencave që ka, ka edhe një përgjegjësi të madhe rreth angazhimeve dhe kryerjes së detyrave, ne po i cekim disa probleme dhe sfida që na shfaqen gjatë kryerjes së punëve:

- Mungesa e stafit profesional në disa sektorë, psh. Zyrtar për qarkullimin rrugor, zyrtar juridik, zyrtar për financa, zyrtar për dhënie e aplikacioneve për regjistrimin e automjeteve, inspektor të Ndërtimit.
- Një sifidë mjaft e madhe është mungesa e veturave zyrtare, ku na shkakton probleme të theksuara si në përgjigjen e kërkesave të shumta të qytetarëve ku nuk kemi mundësi të dalim në terren dhe të bëjmë vlerësimin me kohë reale të gjendjes. Mandej po ashtu edhe në mbikëqyrje të projekteve ku na pamundësohet përcjellja e punëve të kompanive që i mbikëqyrin.
- Kemi edhe probleme të theksuara rreth sigurimit të pajisjeve dhe veglave të ndryshme si dhe materiali tjetër shpenzues që nevojitet për punëtorët e mirëmbajtjes, servisimin e makinave të ndryshme pa të cilat nuk mund të punohet. Këto probleme na shfaqen për shkak se të gjitha këto nuk kanë mundur të përfshihen në kontrata afatgjate, por disa edhe është e pa mundur të planifikohen për shkak të specifikave të punës që paraqiten në terren.

Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi:

Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronësi si organ i administratës komunale në Kamenicë, ka vepruar dhe vepron në zhvillimin e procedurave dhe detyrave konform kompetencave

lëndore të parapara në statutin komunal, rregulloret dhe ligjet në fuqi, bazuar në

evidencën-bazën tekstuale përmes fletëve poseduese, ku janë paraqitur të gjitha informacionet e pronarit dhe pronës, të cilat identifikohen përmes planeve gjeodezike, e tani në formën digjitale – ortofotot që posedon Drejtoria. Drejtoria Kadastro Gjeodezi dhe Pronësi - Zyra kadastra le komunale (ZKKK) e Kamenicës ka për qëllim ofrimin e shërbimeve sa me efikasë për qytetar duke ofruar informacione dhe të dhëna të azhuruara për pronat e paluajtshme, ngritja e cilësisë dhe saktësisë së shërbimeve .

Në mënyrë permanente jemi angazhuar dhe u kemi ofruar shërbime efikase të mundshme qytetare konform kërkesave të tyre dhe realizimin në afate sa më të shpejta.

Angazhimi i jonë është orientuar në një organizim të mirëfilltë në bazë të përpimeve dhe sistemeve të avancuara në nivele të kohës moderne, duke analizuar strategjinë bashkëkohore në bazë të sistemit të avancuar gjyqësor duke aplikuar Ligjin Kundër Diskriminimit në zgjidhjen e problemeve dhe çështjeve, si nga terreni ashtu edhe në zyrë. Një angazhim specifik është se po ballafaqohemi me lëndë nga vite shumë të kaluara, që ende nuk janë zgjidhur e që presin parashtruesit e kërkesave një zgjidhje meritore. Kemi lëndë në procedurë e sipër të viteve para 1999 e këndej e që duhet një angazhim - studim shumë i thellë dhe një procedurë e mundimshme për gjetjen e provave lidhur me kompletimin e lëndës për të gjetur zgjidhje meritore. Shumë lëndë janë të grumbulluara që nga viti 1991 e deri më 1999 nga ish pushteti i atëhershëm, ku dhe vërehen se kanë parregullsi procedurale e që presin zgjidhje, por të njëjtit paraqiten kohë pas kohe. Ne si Drejtori me një staf profesional jemi të përkushtuar për zgjidhje meritore konform bazave dhe afateve ligjore.

Stafi i Drejtorisë tonë është me një përvojë nga e kaluara dhe për çdo lëndë të komplikuar, tubohet, analizon dhe propozon zgjidhje meritore.

Drejtoria për PGJK përbëhet prej tre sektorëve:

- Sektori i Kadastrit
- Sektori i Gjeodezisë
- Sektori i Pronësisë.

Është e njohur se kjo Drejtoria si organ i administratës komunale , qytetareve u shërben si një servis i përhershëm nga tri sektorët në Sektorin e Kadastrit, Gjeodezisë, Pronësisë dhe Zyra për Banime cila nuk funksionon po me kërkesë të OSCS duhet të formohet të jetë aktive ,arsyeja e ndryshimit të ligjit lidhur me regjistrimin e objekteve –banesave . Shërbime u ofrohen lidhur me qasjen e të Drejtave të Pronave për Pasuritë e Paluajtshme, Regjistrat e ndërrimeve të paluajtshmeve si për pronat private ashtu edhe për pronat publike komunale, procedurat e shpronësimit, rasteve për banim social.

Kemi pasur një bashkëpunim të shkallës së lartë edhe me të gjitha Drejtoritë tjera të administratës komunale, posaçërisht me;

Drejtorinë për D.U.P.H,

Drejtorinë për D.SH.P.A.I

Drejtorinë Për D.B.P.ZH.R,

Drejtorinë për D.E.ZH.D.

Nuk ka munguar bashkëpunimi edhe me Drejtoritë tjera sipas nevojës së interesit publik komunal.

Probleme serioze me theks të veçantë në DKGJP-si nuk ka, por është i nevojshëm një bashkëpunim më efikas duke pasur parasysh kohën-afatet ligjore për procedurat administrative dhe atë me Drejtorinë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, me Drejtorinë për Shërbime Publike, Ambientit dhe Inspektorati dhe Drejtoritë tjera.

Është evidente se në DKGJP ka punë të pa ndërprerë dhe numër të konsideruar të lëndëve e që për shqyrtim lypet edhe zënia e afateve ligjore, por duke pasur parasysh numrin e stafit të pakët, na paraqiten edhe vonesa të shqyrtimit të lëndëve. Sa i përket numrit të përgjithshëm të kërkesave që kanë arrit për këtë periudhë pran kësaj drejtorie, të regjistruara dhe të realizuara.

Këto kërkesa të realizuara kanë gjeneruar të hyra për komunën si më poshtë:

Ne si drejtori kemi pas takime te rregullta me AKK lidhur me ndryshimet dhe plotësimet e Udhëzimeve Administrative dhe ligjeve ne fuqi. Kemi pas takime edhe me organizata te ndryshme dhe OJQ te cilat operoj ne republikën e Kosovës.

Vlen te përmendet se edhe këtë vit si drejtori jemi te privilegjuar nga AKK për 5 zona kadastrale për Rindërtim te shënimeve për palët pa pagesë,.

Tabela Nr. 1.

Punët e realizuara në fushën e trashëgimisë, Dhurimit ,shitblerjeve Parcelimeve , bashkimeve etj.

50011 Trashëgimitë								
Nr	Lloji i regjistrimit	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Total

01	Ndarje parcelash	22	18	12	04	03	06	65
02	Bashkim parcelash	05	03	10	02	03	05	28
03	Regjistrimi i ndërtesave	01	02	02	01	00	01	07
04	Ndarja e ndërtesave	00	00	00	00	00	00	0
05	Bashkimi i ndërtesave	00	00	00	00	00	00	0
06	Regjistrimi i pjesëve të ndërtesave	01	02	01	00	01	02	07
07	Ndarja e pjesëve të ndërtesave	00	00	00	00	00	00	00
08	Bashkimi i pjesëve të ndërtesave	00	00	00	00	00	00	00
09	Regjistrimi i hipotekave	06	02	03	00	02	01	14
10	Çregjistrimi i hipotekave	00	00	00	00	00	01	01
11	Regjistrimi i shitblerjeve	43	18	25	26	17	19	148
12	Regjistrimi i trashëgimive	40	14	20	18	17	50	159
13	-/- i faljeve të pronës së paluajtshme	48	21	42	19	29	18	177
14	-/- i ndërrimit të pronës së paluajtshme	00	00	00	00	00	00	00
15	-/- i shkëputjes së bashkësisë familjare	00	00	00	00	00	00	00
16	-/- i përkujdesjes së përfjetshme (Gjykat)	00	00	00	00	00	00	00
17	-/- i pronave të eksproprijuar	00	00	00	00	00	00	00
18	-/- i servitutit	00	00	00	00	00	00	00
19	Çregjistrimi i servitutit	00	00	00	00	00	00	00
20	Regjistrimi i tatimit në pronë	00	00	00	00	00	00	00
21	Çregjistrimi i tatimit në pronë	00	00	0	00	00	00	00
22	Te tjera	14	12	16	06	08	09	65
23	Regjistrim-Çregjistrimi i barrës tatimore	00	00	00	00	00	00	00
24	Regjistrimi i ngarkesave tjera	10	06	00	00	00	03	19
25	Çregjistrimi i ngarkesave tjera	00	00	00	00	00	00	00
26	Regjistrimi i qira mbajtjeve (mbi 3 vjet)	00	00	00	00	00	00	00
27	Çregjistrimi i qira mbajtjeve (mbi 3 vjet)	00	01	00	00	00	02	03
28	Regjistrimi i korrigjimeve në regjistr	02	00	00	0	01	01	04

29	Regjistrimi i rregullimit të kufiri	00	00	00	00	00	00	00	00
30	Regjistrimi i ndërrimit të shfrytëzimit akt	00	00	02	00	00	02	04	
31	Regjistrimi i vërtetimit identiteti	11	04	05	12	14	12	58	
Totali i kërkesave		203	103	118	88	95	132	739	kërkesa
Te hyrat materiale euro		2445	1750	2840	1750	1668	880	11333	euro

Tabela Nr. 2.

Punët e realizuara në fushën e Azhurnimeve, Vektorëve , Parcelimeve , Bashkimeve , Koordinatatave etj.

50504 Matjet									
Nr	Lloji i regjistrimit	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qers hor	Total	
01	Azhurnim	26	22	11	09	10	6	84	
02	Matje	00	00	00	00	00	00	00	
03	Parcelim	08	06	08	7	08	7	44	
04	Bashkim parcelash	08	07	04	03	00	04	26	
05	Kopje plani	03	82	84	75	52	25	321	
06	Matje ndërtesash	00	00	00	00	00	00	00	
07	Caktim kufijsh (Viktor Parcelave)	01	07	09	08	03	02	30	
08	Koordinata	14	10	06	07	15	04	56	
09	Identifikim	00	00	00	00	00	00	00	
10	Ndarje	06	00	02	00	00	00	06	
11	Rregullim kufijsh	00	00	00	00	01	00	01	
12	Të tjera-Aplikacione	00	00	00	00	00	00	00	
Totali i kërkesave		66	134	124	109	89	48	570	kërkesa
Te hyrat materiale euro		2240	2164	1660	1960	1398	597	9958	euro

Tabela Nr. 3.

Punët e realizuara ne fushën dokumenteve te lëshuara: Certifikatave te pronësisë ,kopje planit, Vërtetime etj.

50019 Certifikata									
Nr	Lloji i regjistrimit	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Total	
